

Broshurë teknike

# ISOMAT BATH & KITCHEN

## Bojë plastike cilësie të lartë kundra mykut

### Përshkrimi

Bojë plastike cilësie të lartë kundra mykut për përdorim të brëndshëm. Si rezultat i përbërësve kundra mykut, ISOMAT BATH & KITCHEN parandalon në mënyrë drastike rritjen e mykut dhe të baktereve në vënde me përqendrim të lartë lagëstie dhe avujsh, si në kuzhina, banja, bodrume, etj. Karakterizohet për aftësinë e përsosur mbuluese dhe punshmërinë si dhe rezistencën e lartë ndaj larjes të shpeshtë dhe vjetërsimit. Ofron ngjitje të fortë në çdo lloj sipërfaqeje, të re ose të vjetër si suva, beton, pllaka gipsi, dru etj. Nuk përmban amoniak. Ofron sipërfaqe përfundimtare me një lustër mat të përsosur. I çertifikuar për veprimtarinë kundra baktereve sipas ISO 22196.

### Fushat e zbatimit

ISOMAT BATH & KITCHEN përdoret për aplikime të brëndshme, në sipërfaqe te reja ose të vjetra, në materiale të zakonshme ndërtimi si betoni, suvaja, pllakat e gipsit, etj.

### Të dhënat teknike

Ngjyrat:	e bardha dhe mijëra ngjyra (ISOMAT COLOR SYSTEM)
Lloji:	vinyl
Viskoziteti (Matur me Poise): (EN ISO 2884- 2)	115 ± 5 KU
Vëllimi i lëndëve të ngurta:	44 ± 2 %
Trashësia e cipës së thatë: (EN ISO 2808)	32 ± 3 µm
Dendësia: (EN ISO 2811- 1)	1,46 ± 0,03 kg/l
Fortësia e lidhjes: (EN ISO 4624)	≥ 2 N/mm <sup>2</sup>
pH: (EN ISO 4316)	8-9,5 (+23°C)

Koha e tharjes: 1 orë në 23°C (tharje me prekje)  
(EN ISO 9117)

Koha e rilyerjes: 3-4 orë (23°C)  
(EN ISO 9117)

Përshkueshmëria ndaj avullit:  $S_d = 0,20 \pm 0,04$  m  
(EN ISO 7783- 2: V<sub>2</sub> medium,  $0,14 < S_d < 1,4$ )

Përthithja kapilare e ujit:  $w = 0,04 \pm 0,02$  kg/m<sup>2</sup>h<sup>0.5</sup>  
(EN ISO 1062- 3: W<sub>3</sub> low,  $w < 0,10$ )

Veprimtaria kundra baktereve: E shkëlqyer, R >4,7  
Ngordhja e baktereve >99,9%

(ISO 22196, test kundra Staphylococcus aureus dhe Escherichia coli, kërkesa R >2)

Përmbajtja e VOC-ve: 11,6 g/l

### Matjet sipas EN 13300

Niveli i shkëlqimit: < 5, mat i vdekur  
(EN ISO 2813: < 5 në 85°)

Bardhësia: ≥ 87%

(EN ISO 6504- 3)

Rezistenca ndaj pastrimit

në të lagësht: KLASA 1  
(EN ISO 11998: < 5 µm në 200 cikle larje)

Pastrimi i veglave:

Veglat duhet të pastrohen me ujë menjëherë pas përdorimit.

### Udhëzimet e përdorimit

#### 1. Nënshtrësia

Nënshtrësia duhet të jetë e thatë, pa vaj, materiale të lira, pluhur, etj.

- Plasaritjet ose bashkimet mund të mbushen me mastikën akrilike ISOMASTIC-A.
- Difektet në beton duhet të riparohen me llaçin e modifikuar me polimer DUOCRET.
- Regullimet e suvasë në muret mund të bëhen me llaçet e parapërzier UNICRET dhe UNICRET-FAST.
- Për stokarisjen e sipërfaqeve, përdoret stukoja STUCCOCRET.



# ISOMAT BATH & KITCHEN

Për riveshje sipërfaqeve me rritje myku, është i domosdoshëm pastrimi me pastruesin the ISOMAT kundra mykut CL-MOLD. Pas 24 orësh hiqen shënjat e mykut, bëhet shplarje me ujë të pastër dhe sipërfaqja lihet the thahet krejt.

Vazhdohet astartimi me astarin akrilik me bazë uji dhe të mikronizuar PRIMER-CLASSIC, të holluar deri 50% me ujë të pastër. PRIMER-CLASSIC është gjithashtu ideal të përdoret për stabilizimin e sipërfaqes kur nënshtresa nuk është në gjëndje të mirë ose është e thërrmueshme. Astarimi nuk është i domosdoshëm kur nënshtresa është në konditë të mirë.

Vendosja e astarit nuk është e nevojshme në sipërfaqet tashmë të lyera për sa kohë që boja e vjetër është e padëmtuar. Sipërfaqet e njollosura nga tymi, nikotina, tymrat e shkarkimit, markerët e tretshëm në ujë, lapsat etj. duhet të pastrohen me heqësin e njollave BLOCK-PRIMER.

## 2. Zbatimi

Para përdorimit, materiali përziehet lehtë dhe aplikohet siç është ose i holluar 5-10% me ujë të pastër. Dy shtresat të ISOMAT BATH & KITCHEN aplikohen duke përdorur ryl, furçë ose pistoletë airless. Shtresa e dytë aplikohet mbasi është tharë komplet shtresa e parë. Temperature a aplikimit duhet të jetë ndërmjet +10 °C dhe +35 °C.

## Mbulimi

ISOMAT BATH & KITCHEN mbulon 12 m<sup>2</sup>/l, në sipërfaqe të cilat janë përgatitur që më parë.

## Amballazhimi

ISOMAT BATH & KITCHEN ofrohet në bidona 0,75, 3 dhe 10 l.

## Magazini

Të paktën 24 muaj nga data e prodhimit në thasë të mbyllur, në temperatura ndërmjet +5°C dhe +35°C dhe në vende të mbrojtura nga rezet e diellit dhe ngrica.

## Përbërësit organikë të avullueshëm (VOCs)

Sipas Direktivës 2004/42/CE (Shtojca II, tabela A), përmbajta maksimale e lejuar e VOC-së për produktin e nënkategorisë "a", lloji WB është 30g/l (2010) për produktin e gatshëm për përdorim. Produkti i gatshëm për përdorim ISOMAT BATH & KITCHEN përmban maximum <30 g/l VOC.

## ISOMAT S.A.

BUILDING CHEMICALS, MORTARS & PAINTS  
SELIA NË SELANIK, GREQI

Kilometri i 17të i Autostradës Selanik - Aj. Athanasiu 570 03  
T +30 2310 576 002

[www.isomat.al](http://www.isomat.al) e-mail: [support@isomat.eu](mailto:support@isomat.eu)